

Vonimi i namazit me qëllim të zgjidhjes së problemeve

Islamqa.info

Pyetje: A është e lejuar ta vonosh namazin për ta zgjidhur problem?

Përgjigje: Lavdi Allahut.

Nëse muslimani përpiket t'i pajtojë dy persona ose dy grupe ndërsa hyn koha e namazit dhe ai druan se, po u tërhoq për ta falur namazin, njerëzit mund të shpërndahen pa u arritur pajtimi, atëherë s'është gjë që ta shtyjë faljen e namazit me xhematin e parë dhe të falet më pas me një xhemat tjetër ose vetëm. Kjo është një arsye për mosfaljen e namazit me xhemat ose vonimin e tij.

EI-Buhari (2690) dhe Muslim (421) shënuan nga Sehl ibn Sa'd رضي الله عنه se pati një mospajtim mes disa personave të Benu Amr ibn Auf dhe pejgamberi ﷺ, së bashku me disa sahabë, shkuan tek ata për t'i pajtuar. Kur hyri koha e namazit, pejgamberi ﷺ nuk erdhi në xhami. Bilali رضي الله عنه erdhi dhe thirri ezanin, por pejgamberi ﷺ nuk u shfaq. Kështu, Bilali shkoi te Ebu Bekri رضي الله عنه dhe i tha: "Pejgamberi u pengua (nga ndonjë çështje) dhe ka hyrë e namazit. A do të na udhëheqësh në namaz?" Ai u përgjigj: "Po, nëse do." Bilali bëri ikametin dhe Ebu Bekri doli që t'i udhëhiqte në namaz.

Nëse ke të bësh me një namaz që mund të bashkohet me namazin që vjen pas tij, siç është namazi i drekës, i cili mund të bashkohet me atë të ikindisë, ose ai i akshamit, i cili mund të bashkohet me atë të jacisë, atëherë mund ta bashkosh me namazin e radhës dhe s'ka gjë të keqe që ta shtysh e t'i falësh dy namazet së bashku.

Suneti na tregon se është e lejueshme t'i bësh bashkë dy namaze, nëse ka një arsye për këtë, edhe nëse gjendesh në shtëpi dhe nuk je udhëtar. Ibn Rexheb tha:

"Ahmed (ibn Hanbel) tha se është e lejueshme t'i bësh bashkë dy namaze në rast se je i angazhuar në ndonjë punë që kërkon zgjidhje të menjëhershme. Dhe është përcjellë nga Ibn Sirin se:

'S'ka gjë të keqe që t'i bësh bashkë dy namaze së bashku, kur për këtë ka nevojë, për sa kohë që kjo të mos kalojë në shprehi." (*Fet'h el-Baari* e Ibn Rexheb 3/93)

Për sa i përket shtyrjes së namazit derisa t'i kalojë koha dhe ti nuk e bashkon me namazin e radhës atëherë kur mund të bashkohen, kjo s'është e lejueshme.